



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 78/12
Prishtinë, më 19.09.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa.

Munguan: Latif Gashi dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, dhe Albulena Gashi(praktikant)

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ymer Havolli, Adrian Zalli dhe Vërshim Hatipi nga FKPS, Bedri Hamza Ministër i Financave, Rejhane Zylfijaj (GIZ), monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 11.09.2012;**
3. **Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave;**
4. **Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e ndryshimit të taksës menaxhuese të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që të bëhet rirenditja e pika të rendit të ditës. Pikë e katërt të kalon për shqyrtim si pika e tretë, ndërsa e pika e tretë si pika e katërt. Me këtë ndryshim rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 11.09.2012

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet me përmisimin e disa gabimeve teknike dhe gjuhësore, të identifikuar nga kryetarja që do të përmisohen.

3. Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e ndryshimit të taksës menaxhuese të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryetarja theksoi se nga materiali që është shpërndarë shifet se kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale është për të miratuar taksën menaxhuese prej 0.16% dhe atë vetëm për shpenzime operacionale. Kërkesat e Fondit janë që të ndahet taksa operacionale prej taksës menaxhuese, mirëpo nëse shikohet ligji, shifet se mënyra se si është e përcaktuar në ligj nuk jep sqarime të duhura për mënyrën e përcaktimit të taksës menaxhuese. Pikat k dhe l të nenit 5.2 nuk e sqarojnë sa duhet këtë çështje, dhe kërkesa e fondit në një farë mënyre është pak në kontradit me atë se çfarë është përcaktuar në ligj.

Ymer Havolli theksoi se kërkesa për miratimin e taksës menaxhuese dhe uljen e saj ka ardhur si rezultat i miratimit të ligjit të ri për fondet pensionale. Në bisedë me kryetaren edhe me nënkryetarin e komisionit jemi përpjekur të sqarojmë se taksa menaxhuese prej maksimal 0.30% ka të bëjë me shpenzimet operacionale dhe duke analizuar për atë edhe ju kemi propozuar propozimin për miratimin e taksë në vlerë prej 0.16 % për këtë vit. Pjesa tjetër e cila ka të bëjë me investimet është një pjesë e cila përjashtohet nga taksa menaxhuese dhe sipas ligjit rimburohet nga fondet e pjesëmarrësve të fondit.

Adrian Zalli theksoi se më herët në taksën menaxhuese janë përfshirë shpenzimet operative dhe investive, ndërkaq me ligjin e ri, sidomos alineja L len të kuptohet se shpenzimet e investimeve nuk do të bëhen pjesë e taksës administrative apo menaxhuese të cilat do ti ngarkoj trusti. Duke u bazuar në këtë interpretimin tonë të këtij ligjit e kemi bërë kërkesën për taksën e re menaxhuese 0.16 % për këtë vit që përfshin vetëm shpenzimet operacionale. Trusti do ta ngarkoj vetëm një taks menaxhuese e kjo taks menaxhuese do të shërbej vetëm për shpenzimet operacionale, ndërkohë shërbimet për investime do të barten nga kontribuesit do me than nga vet fondi edhe kjo është praktik që përdoret gjithkund në botë. Mendoj se ka mjaft elemente për ta përkrahur interpretimin tonë mënyrës se si ngarkohet taksa menaxhuese.

Naser Osmani sqaroi se kemi të bëjmë me një çështje që atë që e kemi pasur në mendje nuk e kemi paraqitur mirë në ligj. Pra kërkesa për taksë menaxhuese që kërkohet të ndahen shpenzimet operacionale nga ato investive nuk është definuar si duhet në ligj. Ligji nuk e bënë këtë ndarje mirë dhe e vetmja mundësi me u tejkalue kjo gjendje është të amendamentohet ligji. Kjo është edhe në interes të Fondit, pasi mundet të ketë vërejte prej Auditorit Gjeneral dhe interesi edhe i yni është të mos gaboni as Fondi dhe ne mos të vendosim diqka që ligji nuk ka mbështetje të qartë në ligj.

Muhamet Mustafa theksoi se sigurisht se ne nuk mundemi me dal jashtë ligjit por duhet me gjetur zgjidhje për çështjen e shpenzimeve të investimit të mjeteve apo shpenzimeve të aset menaxherëve, si dhe për shpenzimet operacionale, në mënyrë që Trusti të mos vie në vështërsi së funksionuari. Fatbardhësisht po flasim për vitin e ardhshëm dhe kemi kohë për të gjetur zgjidhjet e më të mira. Kështu Trusti duhet të përgatis buxhetin në bazë të shpenzimeve që Bordi i vlerëson të nevojshme për të dy qëllimet, dhe aty ku ka pengesë ligjore ne mundemi të iniciojmë ndryshimin e ligjit, nëse ligji e pamundëson funksionimin tuaj.

Naser Osmani njoftoi se Fondi për vitin 2012 e ka të aprovuar taksën menaxhuese nga Kuvendi dhe është e mjaftueshme për të gjitha veprimet e nevojshme të fondit. Kërkesa është për miratimin e ndryshimit të taksës për tre pjesën e mbetur të viti, por Kuvendi cakton taksën vetëm për një vit dhe kështu që mbetet në fuqi taksa ekzistuese dhe nuk kemi telashe për vitin 2012. Për mos me ardhë në situatë të vështirë për të përcaktuar taksën e re menaxhuese, unë propozoj që komisioni të merr vendim për iniciimin e ligjit që ka të

bëj me këtë qështje dhe brenda këtij viti Fondi obligohet ti bëjë dhe sjell të gjitha kalkulimet për taksën e re menaxhuese për një operim të suksesshëm.

Kryetarja sqaroi se kërkesa e Fondit nuk është për vitin 2013, por ajo është parashtruar për gjashtë muajt e këtij viti dhe është propozuar shuma prej 0.16% vetëm për shpenzimet operationale. Mendojë që nëse bazohemi në ligj, nuk kemi bazë ligjore për të rekomanduar për një propozim të tillë. Shuma maksimale që mund të rekomandojmë në bazë të ligjit, nuk mund të tejkalojë 0.30%. Më pas kryetarja lexoi dispozitat e ligjit, përkatësisht pikën k dhe l të nenit 5.2 dhe nga përmbajtja e tyre shihet se kemi kundërthënie në mes tyre. Prandaj kërkesa të cilën e ka procedue fondi nuk ka bazën ligjore për tu shqyrtuar dhe rekomanduar. E vetmja mundësi për caktimin e tarifës për vitin e ardhshëm është të iniciojmë procedurën për ndryshimin dhe plotësim e ligjit, përndryshe bazuar në ligjin aktual me rastin e shqyrtimit të taksës menaxhuese nuk ne mund të rekomandojmë më së shumti në vlerë prej 0.30% apo edhe 0.25% si të mendon komisioni dhe këtu duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet e fondit apo i tërë buxheti vjetor.

Muhamet Mustafa meqë është krijuar një situatë e tillë, bordi dhe menaxhmenti i Trustit le të ulen e të shohin çka mund të bëjnë lidhur me operimet dhe shpenzimet e tyre në këtë vit. Ne duhet me gjet një zgjidhje nëse kemi brenda këtij viti, nëse kemi pengesa ligjore, atëherë duhet që ligjin të ndryshojmë me procedurë të shpejtë.

Ymer Havolli theksoi se me propozimin e ri kemi ardhur si rezultat i ndryshimit të ligjit dhe që të mos biem në kundërshtim me ligjin. Unë po mendoj me qëllim të krijimit të qartësisë ligjore, zyra ligjore e Kuvendit dhe BQK-ja të japin opinionin e tyre dhe të marrin një qëndrim lidhur me këtë qështje.

Hykmete Bajrami theksoi se vërtet nuk ka shumë problem sa i përket nenit 5.2, përkatësisht pikës k e cila flet për shpenzimet operationale që duhet të aprovohen përmes taksë menaxhuese që e aprovon Kuvendi dhe pika l e cila flet për shpenzimet investive apo të aset menaxherëve dhe parasheh që Fondi të ketë të drejtën e rimbursimit të mjeteve nga llogarite pjesëmarrësve të fondit dhe këto pika duken të ndara. Mendova që të kërkojmë një mendim nga zyra ligjore për interpretimin e këtij neni dhe nëse është konsultuar kjo zyrë dhe nuk kemi alternativa tjera atëherë nuk mbetet tjetër veç se të ndryshojmë ligjin. Megjithatë në ligj po thotë se nuk duhet kaluar 0.30% dhe këtyre duhet të iu jepet mundësia me e zvogëlue taksën, qoftë për shpenzimet operationale apo edhe për aset menaxher sepse fondi rrite në baza mujore dhe nuk mundem me i shpenzue të gjitha mjetet .

Xhevdet Neziraj mendoj se duhet të ndryshojmë ligjin dhe të rregullohet qartë çështja e caktimit të taksës menaxhuese dhe nuk guxojmë të lëmë mundësinë që të interpretohet në mënyra të ndryshme edhe ligji edhe nenet.

Muhamet Mustafa unë kom propozim konkret që na të kërkojmë prej BQK-së të iniciojnë menjëherë ndryshimin e ligji.

Kryetarja theksoi se ne si Komision mund të iniciojmë ndryshimin e ligjit dhe të zgjidhim këtë problem. Propozoi që komisioni të ndërmarr iniciativën e ndryshimit të neneve të ligjit dhe në punën e grupit punues do të jenë prezent edhe përfaqësuesit e BQK-së, të Fondit dhe të Ministrisë dhe të kryejmë punën bashkërisht.

Muhamet Mustafa unë mendova se ne si komision jemi jashtëzakonisht të ngarkuar dhe propozimi im ishte që punët teknike të kryen nga BQK dhe pastaj të merremi ne si komision. Por nuk jam kundër që edhe Komisioni ynë të merr iniciativën e ndryshimit të ligjit.

Sali Asllani unë po mendoj për afatet kohore dhe kjo iniciativë nëse fillon do të merr një kohë mjaft të gjatë që mundet me shkaktue telashe në funksionimin normal të trustit në vitin e ardhshëm. Të shikohen standardet dhe të gjindet zgjidhja e duhur ligjore që përcakton këtë qështje.

Adrian Zalli deshta me cek që nëse fillohet me procedurën e ndryshimit të kihet parasysh se neni 4.17 flet për çështjen e taksës menaxhuese dhe është i ndërlidhur me nenin 5.2.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PERFUNDIM

- I. Kërkesa e Fondit për miratimin e ndryshimit të taksës menaxhuese të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (që bazohet në kalkulimin e buxhetit vetëm për shpenzimet operacionale të Fondit, duke përjashtuar shpenzimet për investimin e mjeteve pensional) nuk ka bazën juridike në Ligjin nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.
- II. Me qëllim të rregullimit të saktë dhe qartësisht të dispozitave për mënyrën e përcaktimit të taksës menaxhuese, Komisioni për Buxhet dhe Financa vendosi të marrë iniciativën për ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Fondet nr.04/L-101 Pensionale të Kosovës.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave

Kryetarja kandidatët janë propozuar në pajtim me ligji për administratën tatimor, i cili thotë se gjysma e anëtarëve të Bordit zgjidhen qdo vit nga Kuvendi. Janë propozuar gjashtë kandidatë, mirëpo në bazë të një shkrese që kam nga Bordi i ankesave përveç këtyre gjashtë anëtarëve që iu ka skaduar mandati, është edhe një kandidatë që ka dhënë dorëheqje dhe do të doja një informatë nga ministri edhe për këtë çështje. Katër nga kandidatët kanë qenë anëtar të këtij bordi edhe në mandatin e kaluar, ndërsa dy janë të rinj. Nëse i analizojmë CV shohim se i përmbushin kushtet ligjore që i parasheh ligji për të qenë anëtar të Bordit.

Bedri Hamza njoftoi se duke iu falënderuar edhe përkrahjes që ka dhënë ky komision, është arritur që fondi të mbetet funksional dhe i pavarur dhe si rezultat është rritur efikasiteti në punë dhe zvogëlimi apo zgjidhjen e lëndëve. Tani jemi në kontakt me Këshillin Gjyqësor për të funksionalizuar Divizionin Fiskal i cili do të merr kompetencat e Bordit, i cili do të pushojë së funksionuari deri në fund të vitit 2013 dhe deri në këtë kohë duhet zgjidhur të gjitha ankesat e parashtruara. Anëtarët e propozuar pas skadimit të mandatit dhe janë përfillur të gjitha procedurat ligjore në përzgjedhjen dhe propozimin e tyre. Në ndërkohë kemi marrur informacionin se kërkohet edhe një anëtar shtesë për të cilin do të zhvillohen procedurat dhe do të procedohet në Kuvend.

Albana Fetoshi theksoi se sa i përket emërimit të anëtarëve që na vinë nëpër borde të ndryshme, se di se si është e rregulluar me ligj por ndoshta kishte me qenë mirë me i intervistue sepse unë e di se disa komisione e praktikojnë këtë. Ne po marrim CV-në që është në rregull, por kishte qenë mirë me ardhur këtu për të parë se çfarë projekte kanë, si mendojnë me krye punën, sepse nuk mjafton vetëm CV për të bërë vlerësimin sepse nuk po i njohim. Në këtë formë do të ishte dhe një gjykimi më korrekt për secilin prej tyre.

Kryetarja kur kemi çështje të këtilla duhet me i shikue ligjet sepse mënyrën e zgjedhjes e cakton ligji dhe ligji shumë qartë e ka përcaktuar mënyrën se si zgjidhen anëtarët e këtij bordi. Ligji thotë se propozimi vjen nga Qeveria dhe Kuvendi i zgjedh anëtarët, nuk guxojmë me marr në intervista njerëzit pasi që janë të përcaktuar me ligj kriteret për përzgjedhje.

Hykmete Bajrami theksoi se edhe unë e kam të njëjtin shqetësim me Albanën dhe e kam shumë problem me i votue mbështetur vetëm në emrat dhe CV-të e tyre, madje në disa raste ato prezantohen edhe fallso. Është një procedurë shumë formale dhe fundja pse me e votu nëse dikush tjetër i ka zgjedh. Meqenë se sipas ndryshime ligjore kompetencat e këtij bordi kalojnë në gjykatë apo divizionin fiskal, pyes ministrin, sa është afati kohor ky Bord të përfundojë në shqyrtimin e ankesave, në mënyrë që anëtarët të mos zvarritin punën për shkak procedurave dhe të vazhdojnë të marrin paga ashtu edhe të larta.

Bedri Hamza ritheksoi se janë respektuar të gjitha procedurat ligjore në përzgjedhjen kandidatëve. Siç shifet shumica e tyre janë edhe nga mandati i kaluar dhe nuk ka pasur vërejtje për punën e tyre. Puna e tyre kompensohet për pjesëmarrje në seanca që është një kompensim simbolik. Ky bord pritet ti përfundojë lëndët të cilat i ka sipas planit të tyre dhe më së voni 2013, kur edhe do të pushojë së funksionuari si bord dhe kjo qështje kalon në kompetencë të gjykatës, përkatësisht divizioni fiskal. Numri i lëndëve që presin zgjidhje janë rreth 2000 dhe ka rënie të tyre.

Muhamet Mustafa unë e i shikova me kujdes kandidatët dhe po i kuptojë shqetësimet e Hykmetes edhe Albanës, por në këtë rast propozues është Qeveria dhe intervistat zhvillohen atje. Nga anëtarët e propozuar po i njoh dy kandidatë dhe besoj se do të punojnë në zgjidhjen e lëndëve të grumbulluara.

Alban Fetoshi në ligj nuk po shkruan se ne nuk kemi të drejt me intervistue kandidatet e mundshëm, dhe intervistimit i tyre nuk do të ishte në kundërshtim me ligjin. Por edhe nëse ligji nuk është i qartë ne mund të ndryshojmë siq vendosëm edhe më herët për një ligj tjetër dhe nuk do të duhej të ketë pengesa ligjore në të drejtën e marrjes së informacioneve shtesë për kandidatët e propozuar.

Kryetarja ritheksoi se rregullat e zgjidhjes se tyre janë të caktuara qartë dhe ne duhet të respektojmë ligjin edhe duhet të veprojme sipas ligjit

Xhevdet Neziri theksoi se e rëndësishme është të mos ketë ngecje në punë dh funksionalizim të bordit, e nëse dëshirojmë me e ndryshue ligjin mund të bëjmë që të parashihet procedurat tjera, qoftë edhe për intervistimit të kandidatëve.

Sali Asllanaj theksoi se vërejtjet e Hykmetes e Albanës janë me vend dhe me votue diqka qe nuk po e njohim në praktikën tonë parlamentarja ka ndodhur shpesh. Kam një shqetësim për funksionimin e keq të këtij bordi dhe grumbullimin e madh të lëndëve të pazgjidhura dhe ky do të ishte një shqetësim i madhë në të ardhmen në rast se nuk do të zgjidheshin ankesat brenda mandatit të bordit, atëherë do të përballemi me një situatë për vazhdimin e mandatit të këtij bordi. Shqetësimi im është që nuk po i njoh kandidatët e propozuar dhe nuk e di a i meritojnë kandidatët që kanë qenë të përzgjedhur të kenë edhe një mandat tjetër.

Bedri Hamza theksoi se kohëve të fundit duke iu falënderuar edhe mbështetjes së këtij komisioni, përzgjedhja e anëtarëve në këtë bord është realisht e sferës si kërkohet me ligj. Nuk kemi rritje të lëndëve, por zvogëlim të tyre. Edhe pse ligji thotë se së paku shtatë veta duhet të jenë nga komuniteti i biznesit, në bord ka ma shumë se kaq.

Naser Osmani theksoi se vërejtjet tona mund të bazohen nga karakteri të vlerësimit të CV-së. Nga ajo që unë po e shoh në bazë të CV-së, kandidati Bujar Krasniqi po i plotëson kushtet, por nuk kam vërejtje për te tjerët sepse si njoh si persona dhe po ti njifsha se janë të propozuar me ngjyime politike, normalisht se kisha reagua.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me gjashtë votë Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, dhe Muhamet Mustafa) tri Abstenime (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Kundër, nxori këtë

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozim-vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, me mandat deri më 31 dhjetor 2013, si në vijim:

Z. Faik Çollaku, anëtar
Z. Nexhat Hasani, anëtar
Z. Përparim Hoxha, anëtar
Z. Samir Lleshi, anëtar
Z. Bujar Krasniqi, anëtar
Z. Dejan Mitic, anëtar.

Mbledhja përfundoi: 12:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj